



Debat

Shkruan:
Faik KRASNIQIRreziqet nga shteti
grek vazhdojnë edhe sot

Në bazë të kushtetutës greke, kisha ortodokse greke është pjesë e shtetit, dhe gjithë financimi që i bëhet asaj, politikës së Janullatosit, përbën për mua politikën zyrtare greke. Që nga vendosja e saj në Shqipëri dhe deri më sot ka qenë ndër agjenturat më të forta në vend dhe ka punuar e luftuar për helenizimin e jugut të Shqipërisë dhe shtrirjen e ekspansionit grek. Ja çfarë thoshte gazeta "Stohos" një nga gazetët ekstremiste greke: "Vitet që po vijnë janë vitet e helenizimit, i cili përsëri do të luaj rol në tij krijues e historik. Për të luajtur këtë rol helenizimit i duhet të fitoj në radhë të parë tokat e humbura të cilat aktualisht ndodhen sot jashtë kufijve të Greqisë në drejtim të veriut në vijën lumi Shkumbin".

Ja çfarë thoshte Presidenti grek Stefanopollos me rastin e krishtilindjeve: "Unë shtoj bindjen time se Greqia mirëpret shekullin e ri me kujtimet e luftës së përgjakshme për helenizim, për çlirimin e të gjithë grekëve skllëvër, dhe lindjen e çudisë së madhe të ditëve tona atë të qenit grek jashtë vendit. Sot lulëzimi i komuniteteve greke në botë, uniteti i kalitit mes nesh, nën mburojën e kishës greke dhe këshillit botëror të helenëve, është një shpresë e madhe kontributi dhe shpresë për helenizim".

Në ditët më të vështira që po kalonte Shqipëria, në 1997, Greqia mbështeti fuqimisht shkatërrimin e Shqipërisë dhe djegien e jugut duke mundësuar edhe pushtimin final të Shqipërisë, por fal aleatit tonë strategjik Turqisë që atëbotë i tregoi dhëmbët grekut, pushtimi i jugut të Shqipërisë nuk ndodhi.

Ja çfarë i thotë ministri i jashtëm grek Pangallos CNN-it në 1997, kur në të njëjtën kohë aeroplanët grek (ndoshta nga ata F-16) hidhnin trakte në jug të Shqipërisë: "Në radhë të parë Greqia duhet të mbrojë komunitetin që ka në jug të Shqipërisë të cilin ne e quajmë Vorio-epir (dhe dihet sa është V-E për grekët), dhe më pas duhet të mundohemi të marrim pjesë në zgjidhjen e krizës

shqiptare". Ndërhyrja e Greqisë në punët e brendshme të Shqipërisë ka arritur deri në atë masë sa vet Qeveria greke kërkon të bëjë rikshikimin e historisë shqiptare në mënyrë që t'u servir brezave të ardhshëm versionin grek të historisë, ndoshta si ajo pjesa që shqiptarëve u është servuar për çamët, por gjenocidi grek kundër çamëve nuk filloi në 43-in, që në 1913-ën tmerret që ata bënë nuk kishin të parë. Duke krijuar banda hajdutësh, gjoja për tu shkaruar nga përgjegjësia zyrtare, të kryesuar nga kriminelët e neveritshëm Delijanaqi, Harilago nuk lanë gjë pa bërë mbi shqiptarët. Njerëzia merrnin arratinë nga të mundeshin ose fshiheshin pyjeve për t'i shpëtuat vrasjeve mizore. Vajtimi i grave, ulërime e foshnjave në gji të nënave, ishte një tmer. Por, edhe autoritetet zyrtare nuk mbeteshin pa punë, me urdhër të kolonelit Ebitis, u vranë mjaft çamë, në prill të vitit 1913, Drama Çame (për fajin e tyre, greqisht). Në dhjetor të 1999 u themelua Qeveria e Epirit e drejtuar nga princi Aleksandër në tekstin e themelimit thuhet: "ka ardhur koha të kërkojmë, që Epirit t'i jepet mundësia e ushtrimit të vetëvendosjes, e drejt e cila i përket. Tani Qeveria e Epirit ka si detyrë të sigurojë që të drejtat e epirotëve të mos shtypen nga forcat pushtuese të Shqipërisë".

"Qeveria po aplikon për në UNPO dhe po kërkon njohje nga qeveri të tjera. Kërkohe ndihma juaj për të siguruar të drejtat e epiroteve. Lajmëroni përfaqësuesit e qeverisë suaj dhe ju shprehni mbështetjen për një referendum për pavarësinë e Epirit".

Vazhdimësia e rrezikut grek në Shqipëri, sot, po vazhdon akoma, përmes përfaqësuesve grek në Shqipëri, organizatës nacionaliste greke Omonia, nacionalistëve, Mile, Bollano, Dule etj. Andaj për rreziqet që na vijnë gjithmonë nga grekët, dy Qeveritë shqiptare si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë dhe çdo shqiptarë kudo që është, nuk duhet heshtur, por, duhet të ngrihet në këmbë.

Intervistë ekskluzive me Karla del Ponten,
ish-kryeprokuroren e TPI-sëDel Ponte:
Hashim Thaçin
nuk e implikoj
në trafik
organesh!

Ish-kryeprokuroria e Tribunalit të Hagës Karla del Ponte shpreh dëshirën e saj që të punojë si hetuese e pavarur në Kosovë

"Bota sot": Znj. Del Ponte, raporti i Dick Marty-it ka bërë jehonë si në mediet ashtu edhe në qarqet ndërkombëtare. Ky raport po ashtu ka pasur reagime nga Prishtina dhe Tirana. Cili është mendim juaj rreth këtij raporti?

Del Ponte: Siç e dini, unë kam nisur hetimet edhe në kohën kur isha kryeprokurore e TPI-së në Hagë, por nuk kam mundur të vazhdoj ato hetime për arsye të ndryshme. Siç e dini, kam pasur edhe kritika e vërejtje ndaj disa gjërave që kisha vënë unë në librin tim të botuar pas përfundimit të mandatit tim si kryeprokurore. Raportin e Dick Marty-t e kam lexuar me mjaft kujdes ku kam vërejtur disa gjëra interesante dhe të ngjashme që edhe unë pajtohem, por aty kam hasur edhe në shumë gjëra të reja që unë nuk kam ditur deri para daljes publike të këtij raporti dhe pas të gjitha këtyre dëshmimeve, dyshimeve, ne duhet fillojmë një hetuesi në rajon, sepse në Kosovë ka pasur trafik organesh. Prandaj edhe duhet një hetuesi nga një ekip plotësisht i pavarur për

të zhvilluar anketë në Kosovë e më gjerë. Dhe nëse paska pasur trafik organesh dikush duhet të jetë përgjegjës dhe ata duhet gjetur.

Nuk e di pse Marty dyshon në policinë e EULEX-it

"Bota sot": Ju insistoni që hetimet të bëhen të pavarura?

Del Ponte: Hetimet duhet të bëhen nga kushdo qoftë dhe duhet të jenë të pavarura. Për çka nevojitet një ekip, instrumente të nevojshme për t'i dalë në krye kësaj afere në Kosovë dhe natyrisht në bashkëpunim me Kosovën dhe jashtë saj. Unë nuk di, nuk di për atë pse nuk kemi besim në policinë e EULEX-it, sepse Dick Marty është ai që dyshon në këtë polici, sipas të cilit policia e EULEX-it nuk është e aftë dhe nuk është efikase të bëjë një punë korrekte dhe të vihet në dispozicion të mbrojtjes së dëshmitarëve.

"Bota sot": Ju ishit kryeprokurore e TPI-së për vite me radhë, komuniteti ndërkombëtar ka bashkëpunuar vazhdimisht me Hashim Thaçin, emri i të cilit përmendet në raport. Pse atëherë nuk bëtë hetime apo pse nuk arrestuat dikë sa ishit në funksion të kësaj gjykate ndërkombëtare, por tash pas Pavarësisë së Kosovës?

Del Ponte: Jo, jo unë nuk kam përmendur në librin tim Hashim Thaçin dhe nuk implikoj atë në trafik organesh. Nëse e ka përmendur dikush emrin e Hashim Thaçit, ai është Dick



Marty. Për mua zoti Thaçi s'ka të bëjë asgjë me këtë aferë. As unë vetë nuk di kush duhet implikuar në këtë aferë, por thuhet se këtu ishte e implikuar UÇK-ja që padyshim do të kapte apo përfshinte disa persona. Po i kthehem Thaçit, ai ka deklaruar se nuk ka faj në këtë drejtim, është plotësisht i pafajshëm dhe ne i besojmë atij dhe ai do të jetë personi numër një me të cilin duhet bashkëpunuar për ndriçimin e këtyre hetimeve.

"Bota sot": D.m.th. Thaçin ju nuk e akuzoni, ai është i pastër?

Del Ponte: Jo, jo assesi nuk e akuzoj, bile me të njihem nga Konferenca e Dejtonit, atje jemi takuar e kemi biseduar.

Jam e sigurt se Mladiq gjendet diku në Serbi

"Bota sot": Në një intervistë të mëparshme me ne patët deklaruar se nuk do të largoheni nga TPI-ja pa arrestuar të gjithë "peshqit e mëdhenj", d.m.th. kriminelët në Ballkan. Por Mladiq e kriminelët e tjerë serbë që shëtisin në Beograd janë ende në liri?

Del Ponte: Mladiq është një peshk i madh, kriminel i madh i cili gjithnjë gjendet në ikje. Këtu Beogradi duhet të tregohet

Për Thaçin

➔ Po i kthehem Thaçit, ai ka deklaruar se nuk ka faj në këtë drejtim, është plotësisht i pafajshëm dhe ne i besojmë atij dhe ai do të jetë personi numër një me të cilin duhet bashkëpunuar për ndriçimin e këtyre hetimeve.

Për Haradinajn

➔ Nuk di se çfarë po ndodh me të vërtetë, ai doli njëherë në mungesë të provave, që sipas meje ai s'është dashur të lirohet. Por sidoqoftë ai serish u kthye pasi që dikur nuk posedonim prova të mjaftueshme, çka dëshmitarët nuk paskan dashur të dëshmojnë kundër tij dhe ai lirohet.

Për Pacollin

➔ Mesa di unë ai është shkarkuar për shkak të disa mosmarrëveshjeve. Por mund t'ju them vetëm një gjë se edhe nëse rizgjedhet ai, është njeri punëtor dhe do të jetë padyshim një president i mirë i Kosovës.



Milosheviqi vdiq në burg

“Bota sot”: Znj. Del Ponte keni arrestuar kriminelë, të pafajshëm, para jush keni pasur kryesisht njerëz » të aferave të ndryshme, kriminelë e diktatorë . Cili ju ka befusuar apo ka qenë kusht për ju si kryeprokurore e TPI-së ?

Del Ponte : Puna si kryeprokurore aq sa interesante që është, po aq është edhe e vështirë, sepse në Hagë nuk janë ata turistë, por kanë bërë diçka dhe për këtë diçka edhe i kemi futur në burg nga 5, 8, 10, 15 e 20 vjet burg, të cilët kanë i bërë dëm njerëzimit, popullatës civile. Për atë dënjë asgjë nuk mbetet, mos të harrojmë asnjë kriminel në Serbi apo Kosovë. Po për karrierën time ishte për mua interesant dhe sukses kapja dhe prurja e diktatorit Milosheviq në burgun e Hagës të një presidenti të një shteti i cili me aparaturën e tij u printe krimeve dhe masakrave në Kosovë kundër popullatës së pafajshme shqiptare. Por ai vdiq në burg.

“Bota sot” : A vdiq vetë apo u mbyt vetë apo e mbyti dikush për t’ia mbuluar turpin historik Serbisë se ja bota dënon një kriminel të shtetit serb?

Karla del Ponte : Jo, jo ai vetë vdiq.

më kooperativ me TPI-në dhe duhet të ketë vullnet të arrestojë nëse ka pretendime për inkuadrimin e Serbisë në Bashkimin Evropian. Karaxhiqin e kanë arrestuar, por vullnet të tillë politik duhet të tregojë Beogradi edhe me arrestimin e Mladiqit dhe ta gjejnë ku është dhe unë jam e sigurt se ai është diku në Serbi dhe tash Beogradit duhet ta tregojë veten. Besoj se do ta gjejnë një ditë dhe pse ai po përpiqet të fshihet nga një pjesë e popullatës dhe po strehohet nga shtëpia në shtëpi. Edhe këto ikje të Mladiqit një ditë do ta kenë fundin e vet dhe do të jetë vizitori i radhës në Hagë.

“Bota sot” : Pas daljes në sipërfaqe të raportit të Dicka Marty-it flitet me të madhe rreth një « shtëpie të verdhë » në veri të Shqipërisë. Për këtë arsye ministri serb Jeremiq në Gjenevë ka implikuar edhe Tiranën zyrtare në këtë aferë të trafikut të organeve. Pse Tiranë ?

Del Ponte: Nuk duhet të mer-

remi me supozime. Ministri serb Jeremiq duke implikuar Tiranën mund t’ia ketë futur kot. Por mos harroni se ekziston kjo shtëpi e verdhë, ne kemi qenë atje, e dimë se çfarë ka ndodhur aty, ne kemi bërë hetime dhe se kjo aferë s’ka të bëjë asgjë me Shqipërinë apo me Tiranën, përkundrazi Tirana ka ofruar bashkëpunim në këtë drejtim. Pra për t’i hedhur poshtë të gjitha këto se janë apo s’janë spekulime e bëjmë një anketë, kush dhe cili ka gishta në këtë aferë të trafikut të organeve në Kosovë dhe pikë. Prandaj edhe njerëzit mund të akuzojnë kë të duan, por s’ është ashtu. Prandaj edhe nevojitet një hetuesi në rajon.

“Bota sot”: Nga përgjigjet e juaja kam përshtypjen se ju keni dëshirë t’u prini këtyre hetimeve në Kosovë. Meqë tash jeni në pension, mendoni se jeni e gatshme të kryeni një detyrë të tillë, nuk jeni lodhur ende ?

Del Ponte: Po natyrisht pas

mbarimit të mandatit tim si ambasadore padyshim kam dëshirë të jem në krye të këtyre hetimeve për trafik organesh në Kosovë pasi unë e kam nisur këtë dhe kam dëshirë t’i dal në fund.

“Bota sot”: Po po çfarë po ndodh me çështjen e Ramush Haradinajt .Kemi një përshtypje se kjo gjykatë tashmë është bërë si një “vetëshërbim” ku dalin e hyjnë herë të akuzuar e herë të liruar?

Del Ponte : Nuk di se çfarë po ndodh me të vërtetë, ai doli njëherë në mungesë të provave, që sipas meje ai s’është dashur të lirohet. Por sidoqoftë ai serish u kthye pasi që dikur nuk posedonim prova të mjaftueshme, çka dëshmitarët nuk paskan dashur të dëshmojnë kundër tij dhe ai lirohet. Por , tash presim se çfarë tregon procesi kundër tij...

“Bota sot”: Znj. Del Ponte keni arrestuar kriminelë, të pafajshëm, para jush keni pasur kryesisht njerëz » të aferave të ndryshme, kriminelë e diktatorë . Cili ju ka befusuar apo ka qenë kusht për ju si kryeprokurore e TPI-së ?

Del Ponte : Puna si kryeprokurore aq sa interesante që është, po aq është edhe e vështirë, sepse në Hagë nuk janë ata turistë, por kanë bërë diçka dhe për këtë diçka edhe i kemi futur në burg nga 5, 8, 10, 15 e 20 vjet burg, të cilët kanë i bërë dëm njerëzimit, popullatës civile. Për atë dënjë asgjë nuk mbetet, mos të harrojmë asnjë kriminel në Serbi apo Kosovë. Po për karrierën time ishte për mua interesant dhe sukses kapja dhe prurja e diktatorit Milosheviq në burgun e Hagës të një presidenti të një shteti i cili me aparaturën e tij u printe krimeve dhe masakrave në Kosovë kundër popullatës së pafajshme shqiptare. Por ai vdiq në burg.

“Bota sot” : A vdiq vetë apo u mbyt vetë apo e mbyti dikush për t’ia mbuluar turpin historik Serbisë se ja bota dënon një kriminel të shtetit serb?

Karla del Ponte: Jo, jo ai vetë vdiq.

“Bota so”: Behgjet Pacollin e njihni mirë. Çfarë mendoni për të?

Del Ponte: Unë nuk di çfarë flasin të tjerët për zotin Pacolli. Mesa di unë ai është shkarkuar për shkak të disa mosmarrëveshjeve. Por mund t’ju them vetëm një gjë se edhe nëse rizgjedhet ai, është njeri punëtor dhe do të jetë padyshim një president i mirë i Kosovës. ■

Karla del Ponte në bisedë me redaktorin tonë Nefail Maliqin



Bota Sot ONLINE
lexojeni këtë tekst në internet.
Klikoni: www.botasot.info

Refuzon të përgjigjet ftesës së prokurorisë së EULEX-it



Blerim Kuqi dënohet me 30 ditë paraburgim

PRISHTINË, 5 PRILL ■ Kuqi është ftuar të dëshmojë për prokurorinë e EULEX-it që nga tetori i vitit 2010. Një gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës ka urdhëruar

një muaj burgim për Blerim Kuqin, aktualisht kryetar i Komunës së Suharekës. Dënimi vije si pasojë e refuzimit të përsëritur të Kuqi që të përgjigjet në pyetjet e prokurorit në lidhje me një hetim penal. Një gjë të tillë e kanë konfirmuar zyrtarë të EULEX-it. “Burgimi, i cili është i parashikuar në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, do të zgjasë për sa kohë që dëshmitari refuzon të dëshmojë apo derisa dëshmia e tij bëhet e panevojshme, ose derisa të përfundojë procedura penale, por nuk duhet të kalojë afatin prej një muaji. Hetimi është duke u udhëhequr nga një prokuror i Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK-së)”, ka thënë zëdhënësjë e EULEX-it, Kristina Herodes. Të hënën në mëngjes, në shtëpinë e tij ka shkuar EULEX-i cili ia paraqitur Kuqit urdhrin për arrest nga ana e gjyqtarit, urdhër i cili është lëshuar si rezultat i refuzimit të tij për tu paraqitur në gjykatë. Ai është shoqëruar nga ana e EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, ku për rreth tre orë është marrë në pyetje ku edhe u vendos që Kuqit ti caktohet masa e paraburgimit.

EULEX-i nuk ka bërë të ditur se për çfarë hetimi bëhet fjalë. Mirëpo, burimet e gazetës bëjnë të ditur se arrestimi i Kuqit ka ardhur për arsye se ky i fundit kishte refuzuar që të dëshmojë në rastin “Kleçka”, ku janë të dyshuar disa ish pjesëtarë të UÇK-së, përfshirë edhe nënkryetarin e PDK-së, Fatmir Limaj. Blerim Kuqi, aktualisht kryetar i Kaçanikut i janë caktuar 30 ditë paraburgim nga një gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës. Ndërkohë, në aktvendimin për urdhër të burgimit të lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ferdinando Buatier de Mongeot, thuhet se paraburgimi do të zgjasë për një periudhë prej një muaji, si

rrjedhjeje me afat të skadimit në 4 maj 2011. Në vendim po ashtu thuhet se i burgosuri (Blerim Kuqi) do të mbahet gjithnjë i ndarë nga të pandehurit e tjerë në këtë procedurë. Ndërsa, në arsyetimin e vendimit thuhet se dëshmitari Blerim Kuqi, është marrë në pyetje në rastin e parë nga prokurori, më 4 tetor 2010, dhe ai ka refuzuar që të përgjigjet në pyetjet e shtruar atij, përkundër, siç thuhet, pa dyshim që ka ditur përgjigjet. Në arsyetimin e vendimit të lëshuar nga gjyqtari i EULEX-it, thuhet se Blerim Kuqi po ashtu ka pranuar se nuk ka arsye ligjore për mos përgjigje. Arsyetimi vazhdon me atë se më 29 tetor 2010, ai përsëri tek hetuesit ka thënë se nuk e kishte ndërruar mendjen nëse të përgjigjet në pyetjet e prokurorit apo jo. “Më 2 dhjetor 2010, gjyqtari i poshtëshënuar i procedurës paraprake ka gjobitur atë me 250 euro, në pajtim me nenin 167, të KPPK-së. Më 14 tetor, ai përsëri ishte ftuar dhe pasi që ishte paralajmëruar për pasojat e mundshme për refuzimin e tij që të përgjigjet, ai përsëri se nuk e kishte ndërmend. Faktet e lartë përmendura sjellin atë që kushtet legale të cilat parashihen me nenin 237 paragrafin 3 (në lidhje me 167, paragrafi 2), të KPPK-së janë përmbushur.

Gjykatësi i seancës paraprake ka mbajtur një seancë pasi dëshmitari është burgosur edhe pse një seancë e tillë nuk parashikohet specifikisht nga Kodi i Procedurës Penale, në mënyrë që ti mundësojë zotit Blerim Kuqi për të shpjeguar pozicionin e tij.

Ndërkohë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) të martën shprehu shqetësimin për burgosjen prej 30 ditësh të Blerim Kuqit, sekretar organizativ i AAK-së dhe kryetar i komunës së Suharekës, për shkak të refuzimit të dëshmisë për të njoftuar luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. AAK ftoi EULEX-in që t’i përmbahet prioritetëve të veta për sundimin e ligjit në Kosovë dhe që të mos prek në luftën e drejtë të shqiptarëve të Kosovës për liri, demokraci dhe pavarësi. ■ **Teuta Rexhepi**